



Data: 12/08/21 Ref.: 3023/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113(Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037(Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Edukim Fillor, BA, 240 ECTS, maksimumi 90 studentë për vit akademik;
 - Edukim Parashkollor, BA, 240 ECTS, maksimumi 70 studentë për vit akademik;
 - Infermieri, BSc, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik.
- II. Akreditohen programet e studimit, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, BA, 240 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik;
 - Kujdesi dhe mirëqenia Sociale, BA, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik;
 - Gjuhë Angleze - Përkthim dhe interpretim, BA, 180 ECTS, maksimumi 70 studentë për vit akademik;
 - Fizioterapi, BA Profesional, 180 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik;
 - Shëndeti Publik, BSc 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik;
 - Menaxhimi shëndetësor MA, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik;
- III. Nuk akreditohen programet e studimit:
 - Gjuhë Shqipe dhe Letërsi MA, 120 ECTS.
- IV. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- V. Obligohet Universiteti të Gjakovës “Fehmi Agani” që deri më 15 nëntor të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Universiteti të Gjakovës “Fehmi Agani”, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim dhe akreditim të programieve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

| <i>Nr.</i> | <i>Programi i studimit</i> | <i>Bartësit e programit</i> |
|------------|--|---|
| 1 | Edukim Fillor, BA, 240 ECTS | Nexhmije Kastrati Ruzhdi Kadrija Ilmi Hoxha Lulzim Zeneli Valdet Hysenaj Ilir Kelmendi |
| 2 | Edukim Parashkollor, BA, 240 ECTS | Sindorela Doli Drita Kadriu Edita Haxhijaha Venera Kendusi Zeqir Hashani Mimoza Kushumlia |
| 3 | Infermieri, BSc, 180 ECTS | Arta Dalipi Bekim Sejdiu Argjiro Alija Idriz Berisha Besarta Pelaj Vanesa Tanushi Kushtrim Grezda |
| 4 | Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, BA, 240 ECTS | Besim Muhadri Muharrem Gashi Fitor Ollomani Labinot Berisha |
| 5 | Kujdesi dhe mirëqenia Sociale, BA, 180 ECTS | Behxhet Gaxhiqi Shefqet Mulliqi Shqipe Husaj Ramush Bejiqi |
| 6 | Gjuhë Angleze – Përkthim dhe interpretim, BA, 180 ECTS | Laura Naka Nazli Tyfekqi Elsa Vula Sazan Kryeziu |
| 7 | Fizioterapi, BA Profesional, 180 ECTS | Arben Boshnjaku Bylbyl Kadrija Vesa Rraci Rilind Obertinca Vjola Nagavci Edita Çufaj Kadrija Skender Ukaj Hateme Hoxha |
| 8 | Shëndeti Publik, BSc 180 ECTS | Haxhi Kamberi Antigona Ukëhaxhaj Hajrullah Latifi |

| | | |
|----|--|--|
| 9 | Menaxhimi shëndetësor MA, 120 ECTS | Dardan Koqinaj; Artan Nimani Faton Hoxha |
| 10 | Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, MA, 120 ECTS | Kamber Kamberi Fridrik Dulaj |

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar një vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani", me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizitat janë organizuar më 10.03.2021, 11.03.2021 dhe 26.05.2021 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Dhurata Shehri, Milan Pol, Marija Vasilevska, Janez Vogrinc, Janez Kerk, Andrew Goodspeed, Danica Zeleznik, Delia Gologan dhe Wolfgang Patsch.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të Ekspertëve Ndërkombëtarë kanë hartuar raportet e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Edukim Fillor, BA, 240 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht dy (2) kapituj, substancialisht katër (4) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht një (1) kapitullë.
2. Për programin e studimit Edukimi Parashkollor, BA, 240 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht dy (2) kapituj, substancialisht katër (4) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht një (1) kapitullë.
3. Për programin e studimit Infermieri, BSc, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht shtatë (7) kapituj.
4. Për programin e studimit Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, BA, 240 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht një (1) kapitull, substancialisht katër (4) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht dy (2) kapituj.
5. Për programin e studimit Kujdesi dhe mirëqenia Sociale, BA, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht dy (2) kapituj dhe substancialisht pesë (5) kapituj.
6. Për programin e studimit Gjuhë Angleze – Përkthim dhe interpretim, BA, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht një (1) kapitull, substancialisht katër (4) kapituj dhe pjesërisht dy (2) kapituj.
7. Për programin e studimit Fizioterapi, BA Profesional, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht gjashtë (6) kapituj dhe pjesërisht një (1) kapitull.


8. Për programin e studimit Shëndeti Publik, BSc 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht dy (2) kapituj, substancialisht katër (4) kapituj dhe pjesërisht një (1) kapitull.

9. Për programin e studimit Menaxhimi shëndetësor MA, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht pesë (5) kapituj dhe pjesërisht dy (2) kapituj.

10. Për programin e studimit Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, MA, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht tri (3) kapituj dhe pjesërisht katër (4) kapituj.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07 dhe 27 korrik 2021 kanë shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti të Gjakovës “Fehmi Agani”;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.